

VENDIM
Nr.83, datë 4.11.2009

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TEODORI 2003” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 13, 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson plotësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike,

- Të formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Të dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Të dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Të dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4),

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Zall Bulqizë me fuqi 5.350 MW dhe HEC i Ternovës me fuqi 8.385 MW.

2. “TEODORI 2003” sh.p.k. të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Zall Bulqizë dhe HEC i Ternovës sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

3. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta